



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

RAPORTI VJETOR I PUNËS

PËR VITIN 2014

Janar 2015

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Z. Arben SKËNDO

Të nderuar qytetarë!

Tashmë është bërë traditë që t'ju paraqesim në përfundim të vitit, një Raport Vjetor të Punës së Shërbimit, i cili është një konsiderim real i punës sonë gjatë një viti plot ritëm dhe bashkëveprim të organizatës tonë me strukturat, Policinë e Shtetit dhe agjencitë ligjzbatuese në vend.

Viti 2014, ka qenë viti i reformimit më të madh të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në aspektin ligjor e nënligjor, të përjasjes më shpejtësi me agjencitë homologe në vendet e EPAC-ut (Vendet Europiane Kundër Korrupsionit) dhe BE-së, të ndryshimit metodologjik e konceptual për ta nxjerrë Shërbimin nga “pellgu i ndenjtur” i represionit dhe korrupsionit dhe vënë atë në shërbim të qytetarit, publikut të interesuar për rendin dhe sigurinë, por edhe si një partner korrekt e të vlerësuar nga strukturat me të cilat bashkëpunojmë e ndajmë aktivitetet ligjzbatuese.

Vizioni i përcaktuar në dokumentin strategjik të prioriteteve dhe objektivave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe orientimeve të Z. Ministër për Shërbimin tonë, na dhanë shtysën kryesore për të ndërruar këto reformë ligjore, organizative dhe të integruar për ta kthyer Shërbimin në një organizatë të përgjegjshme, llogaridhënëse dhe efiçente ligjzbatuese, të njohur prej publikut e më gjerë, si dhe bashkëvepruese me Policinë e me standarde profesionale objektivisht të pacënueshme e të qëndrueshme në kohë.

Gjithashtu falenderojmë dhe shprehim mirënjohjen për qeverinë dhe Z. Ministër, në vlerësimin e punës së Shërbimit, e shprehur kjo edhe në motivimin e konsiderueshëm financiar të shprehur në rritjen e pagave të personelit të Shërbimit dhe ekuivalentimin e gradave të punonjësve.

Në këtë Raport Vjetor të Punës kemi trajtuar çështje që konsiderohen shtylla të zhvillimit të brendshëm për arritjen e vizionit që duam të arrijmë me shpejtësi. E gjithë puna jonë është ndërtuar për të dhënë produkte në strategjinë anti-korrupsion, përmbushjen e misionit për rritjen e standardeve profesionale bashkëkohore, rritjen e performancës së Strukturave dhe të vetë Shërbimit. Gjithashtu jemi orientuar nga parimi dhe filozofia e fitimit dhe ruajtjes së besimit të publikut e cila është esenciale nëse Shërbimi kërkon që të ketë mbështetjen e komunitetit dhe të organizatës policore.

Raporti Vjetor i Punës për Vitin 2014 është një material analitik i treguesve kryesor të Shërbimit, që shprehin më së qarti hapat në të cilat kemi ecur, arritjet më të mira, zhvillimet modeste por edhe kapërcimet befasuese të disa treguesve kryesisht mbi impaktin në marrëdhëniet me publikun, operacionet policore etj. Në këtë analizë nuk ka vetëm “paradë” suksesesh por një moment ndalës për të parë se çkemi bërë mirë, çmund të bëjmë më mirë se kaq dhe të përcaktojmë objektivat sfiduese për vitin 2015.

Aktualisht pas 1 viti kemi hedhur themelet e një strukture të re në zixhirin e agjencive ligjzbatuese si nga përmbajtja ashtu edhe nga organizimi. Faza e implementimit që kemi filluar e parashikuar të përfundojë për një periudhë 2-vjecare është po kaq e rëndësishme dhe vendimtare për konsolidimin e Shërbimit dhe jemi të qartë e të bindur se janë të gjitha mundësitë e kapacitetet profesionale për arritjen e këtij suksesi.

Si përfundim, të bindur se forcimi i kapaciteteve tona të brendshme në përmbushjen e misionit dhe objektit të veprimtarisë, bashkëveprimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me agjencitë ligjzbatuese në vend, rritja e bashkëpunimit dhe besimit të ndërsjelltë me Strukturat si dhe forcimi i bashkëpunimit dhe rritja e besimit të publikut tek Shërbimi, janë çelësi i suksesit për një mbikqyrje dhe kontroll të jashtëm qytetar efikas dhe efiçent, ftojme qytetarët dhe institucionet, të na mbështesin në punën tonë.



Foto nga analiza vjetore e Shërbimit për vitin 2014

PRIORITETET PËR VITIN 2014

E gjithë veprimtaria e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, gjatë vitit 2014, është mbështetur në angazhimet e ndërmarra nga Ministria e Punëve të Brendshme, të reflektuara dhe pasqyruara në Programin Vjetor të Punës për vitin 2014, me prioritetet kryesore, si:

- I. **Reformimi ligjor e organizative i Shërbimit,**
- II. **Masat për përmbushjen e misionit, objektit të veprimtarisë dhe angazhimeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe shkelje të tjera të ligjit nga punonjësit e Policisë së Shtetit.**

I. REFORMA LIGJORE

Këtij reformimi i parapriu një studim, vlerësim dhe ekspertizë e kryer nga ekspertët më të mirë të vetë Shërbimit, të konsultuar me ekspertët e misioneve partnere që operojnë në vendin tonë, duke evidentuar si domosdoshmëri reformimin ligjor e organizative të Shërbimit, të konkretizuar në:

- Hartimi dhe miratimi i ligjit **nr.70/2014** për **“Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”**. Ligj i cili do të shndërrojë Shërbimin në një agjenci të mbikqyrjes së jashtme qytetare të Strukturave.
- Hartimi dhe miratimi i **4 Vendimeve të Këshillit të Ministrave:**
 - **VKM nr. 829, datë 03.12.2014** “Për miratimin e Rregullores së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
 - **VKM nr. 740, datë 05.11.2014** “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat e personelit operacional në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
 - **VKM nr. 741, datë 05.11.2014** “Për përcaktimin e kushteve, kritereve të përdorimit dhe kontrollit të fondit të posacëm, në funksion të veprimtarisë hetimore dhe procesit informativ të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
 - **VKM nr. 776, datë 19.11.2014** “Për disa të drejta të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
- Hartimi dhe miratimi i **12 Urdhrave dhe Udhëzimeve të Ministrit të Punëve të Brendshme** mbi bazën e të cilave, në zbatim dhe implementim të ligjit, normohen disa nga veprimtaritë kryesore të strukturave të Shërbimit si:
 - **Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 658, datë 14.11.2014** “Për procedurat e kontrollit të dokumenteve dhe evidencave, kërkimit dhe marrjes së të dhënave në Struktura si dhe bashkërendimi i punës së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat me strukturat dhe ato të Ministrisë së Punëve të Brendshme”.
 - **Urdhri i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 602, datë 19.11.2014** “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”,

- **Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 655, datë 14.11.2014** “Për procedurat standarde të punës së Njësisë së Inspektimit”.
- **Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 656, datë 14.11.2014** “Për përcaktimin e procedurave, kritereve dhe mënyrave të administrimit të paralajmërit”.
- **Urdhri i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 657, datë 14.11.2014** “Për përcaktimin e formës, të dhënave dhe rregullave të përdorimit të dokumentit të identifikimit të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.
- **Urdhri i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 659, datë 14.11.2014** “Për miratimin e formulës dhe procedurës së betimit të punonjësit të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
- **Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 654, datë 14.11.2014** “Mbi burimet e informacionit dhe rrjetin e fshehtë informativ”.
- **Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 653, datë 14.11.2014** “Mbi procesin informativ”.
- **Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 652, datë 14.11.2014** “Për mbikqyrjen e fshehtë të personave e mjediseve, nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe procedurat standarde gjatë aplikimit të tyre”.
- **Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 675, datë 05.12.2014** “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e pagesës për disa të drejta të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
- **Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 676, datë 05.12.2014** “Për përdorimin dhe kontrollin e fondit të posaçëm për shpenzime në funksion të veprimtarisë hetimore dhe procesit informativ të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.
- **Urdhri i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 300, datë 06.10.2014** "Për procedurat e pajisjes së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, me armë zjarri, mjete të tjera të përdorimit të forcës e mbrojtjes, llojet e tyre, mënyrën e administrimit dhe përdorimit".

SHËRBIM CIVIL DHE RITJE TË DIVERSITETIT GJINOR

Ritja e përbërjes civile të Shërbimit, duke balancuar raportin midis personelit me grada dhe pa grada të Shërbimit, një mjet për të rritur besimin e publikut në aftësitë për kryerjen e hetimeve të paanshme dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me ankesat individuale dhe denoncimet për shkeljet.

Ritja e diversiteti gjinor – një tjetër përpjekje serioze për përmirësim pozitiv i Shërbimit gjatë vitit 2014. Në një personel prej 104 punonjësish, numri i femrave gjatë vitit 2013 zinte vetëm **9.5%** të numrit të përgjithshëm të personelit, ndërsa për vitin 2014, për një personel prej 104 punonjësish, numri i femrave arriti të zëre rreth **17.3%** të numrit të përgjithshëm. Pra një tendencë në rritje e përfshirjes dhe promovimit të personelit femër në strukturat e Shërbimit, e cila do të vazhdojë edhe në vitet në vazhdim, për tu bërë pjesë e axhendës së zhvillimit të shoqërisë shqiptare në këtë drejtim.

REFORMA STRUKTURE DHE ORGANIZATIVE

Këtij reformimi i paraprin një studim i thellë i kapaciteteve të Shërbimit si dhe miratimi i Urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme **nr. 84, datë 25.03.2014** “Mbi miratimin e Strukturës dhe organikës së Shërbimit”, e konkretizuar në:

- **Riorganizimi dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të inspektimit dhe ankesave:**
 - Ngritja e Sektorit të Inspektimit të Ankesave, pjesë e së cilës është Zyra e Informacionit dhe Ankesave të Publikut.
 - Urdhri **nr. 1126, datë 23.05.2014** i Drejtorit të Përgjithshëm për “Protokollet e punës gjatë trajtimit dhe inspektimit të Ankesave”, akt administrativ që ka munguar më parë.
 - Letër - Porosia **nr. 1654, datë 05.12.2013** e Drejtorit të Përgjithshëm “Për trajtimin dhe shqyrtimin me efikasitet, efikasitet, përgjegjshmëri dhe paanësi të çdo ankesë për punonjës të Policisë së Shtetit, nga strukturat e Shërbimit në nivel vendor e qendror”.
 - Rivendosja në punë e linjës jeshile **0800 90 90**, instalimi i aparaturës rregjistruese të thirrjeve telefonike 24 orë në 24.
 - Instalimi dhe përdorimi i bazës së të dhënave të rasteve/ankesave/informacioneve të publikut e cila garanton një përpunim të shpejtë dhe dokumentim të të gjitha procedurave të ndjekura për trajtimin e ankesës deri në përfundimin e saj. (me ndihmën e ICITAP).
 - Krjimi i faqes së internetit të Shërbimit me një informacion të detajuar mbi të gjitha portat e mundshme të komunikimit të publikut me shërbimin, si dhe pasqyrimin e aktiviteteve të Shërbimit.

- **Riorganizimi dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të hetimit dhe analizës së informacionit:**
 - Organizimi në nivel qendror dhe në Drejtorinë e Shërbimit për Tiranën në 2 sektorë atë të 1. Kërkimit dhe hetimit dhe 2. Drejtimit të hetimit.
 - Ngritja e sektorit të Drejtimit të Hetimit, me qëllim drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë së hetimit paraprak dhe procedural të kryer nga strukturat në nivel qendror dhe vendor, si dhe ndjekjen e çështjeve penale më të rëndësishme.
 - Ngritja e arkivës në veprim, pranë zyrës së kartotekës, sigurimi i zyrës, pajisja me mjetet e nevojshme logjistike dhe nisja e procesit të sistemimit dhe inventarizimit të dokumentacionit ndër vite të Shërbimit.
 - Ngritja e zyrës së intervistimit, në aparatën e MPB (drejtoria e përgjithshme e shërbimit) me pajisje të dhuruara nga ICITAP.
 - Hartimi dhe zbatimi i Letër - Porosisë nr. 531, datë 27.08.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm për “Monitorimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit penal për krimin mjedisor”, për strukturat e Shërbimit në nivel vendor e qendror;

- Hartimi dhe zbatim i Planit të Masave në bazë të Urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 159, datë 29.05.2014 “Për garantimin e një shërbimi policor demokratik, transparent dhe etik gjatë sezonit turistik 2014 në fushën e qarkullimit rrugor dhe menaxhimin e hyrje/daljeve në kufi”, në bashkëpunim me Inspektimin e Përgjithshëm të Ministrit.
- Hartimi dhe zbatimi i Programit të trajnimit të brendshëm të personelit të Shërbimit miratuar me Urdhër Ministri nr. 7807/1, datë 25.09.2014, me qëllim rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të performancës së personelit të shërbimit gjatë ushtrimit të detyrës funksionale.

TRAJNIMI I VAZHDUESHËM I PERSONELIT TË SHËRBIMIT

Me mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve tanë e në veçanti të programit ICITAP dhe misionit PAMECA-IV edhe gjatë vitit 2014 janë zhvilluar disa trajnime për personelin hetues dhe inspektues të Shërbimit. Gjithashtu, mbi bazën e një Programi për Trajnimin e Brendshëm, një risi mbi baza profesionale shkencore për ngritjen profesionale të personelin operacional dhe inspektues të Shërbimit, janë zhvilluar disa trajnime gjatë muajit Dhjetor 2014, proces i cili do të vazhdojë edhe përgjatë gjithë vitit 2015.

- Trajnimi 3-ditor nga data 17 -19 Shkurt 2014, i organizuar nga PAMECA-IV mbi “hetimin bazë” për personelin hetues të Shërbimit, i drejtuar nga eksperti i këtij misioni Z. Gilles Locchi. Trajnimi u bazua në gërshetimin e anës teorike të shpjegimit të hetimit dhe anës praktike të kryerjes së një hetimi, kryesisht të rasteve të korrupsionit dhe trafikut të drogës.



- Trajnimi i organizuar nga ICITAP, me temë “Zhvillimin e Aftësive Inspektuese”, për personelin inspektues të Shërbimit, gjatë periudhës Maj – Dhjetor 2014.



FORCIMI I MEKANIZMAVE TË VETKONTROLLIT TË BRENDSHËM

Në funksion të mekanizmeve të vetëkontrollit të brendshëm, të vlerësimit të performancës së gjithësecilit nga punonjësit e personelit të shërbimit, evidentimit të shkeljeve të lehta apo të rënda disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës funksionale, gjatë vitit 2014, janë inicuar **25** procese disiplinore dhe janë dhënë **25** masa disiplinore të lehta dhe të rënda për **25** punonjës të shërbimit, e konkretisht:

Masat disiplinore të dhëna:

- | | |
|-------------------------------------------------|-----------------|
| – “Vërejtje” | për 1 punonjës |
| – “Vërejtje me shkrim” | për 19 punonjës |
| – “Vërejtje me paralajmërim” | për 1 punonjës |
| – “shtyrje e afatit të gradimit për 12 muaj” | për 2 punonjës |
| – “gjobë sa masa e 5 ditëve pune të punonjësit” | për 2 punonjës |

Në funksion të ligjshmërisë dhe respektimit të kriterëve të parashikuara në ligj dhe në rregulloren e personelit, gjatë këtij viti nga strukturat e Shërbimit janë larguar dhe përjashtuar **13** punonjës, ku:

- 8 punonjës larguar me motivacionin “për mospërbushje të kriterëve të marrjes në punë”.
- 4 punonjës përjashtuar me motivacionin “për shkelje ose mosushtrim i kompetencave që ka sjelle pasoja të rënda”.
- 1 punonjës larguar “pasi është vlerësuar i paaftë në kryerjen e detyrave të ngarkuara, pas 2 vlerësimeve negative të njëpasnjëshme të punës dhe 3 masave disiplinore”.

II. PËRMBUSHJA E MISIONIT E OBJEKTIT TË VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT

Trajtimi i ankesave të publikut dhe inspektimi i strukturave të Policisë së Shtetit

– SEKTORI I INSPEKTIMIT TË ANKESAVE

Janë trajtuar dhe hetuar administrativisht **838** ankesa për vitin 2014, kundrejt **151** ankesave të trajtuara gjatë vitit 2013.

Nga trajtimi i **838** ankesave, në:


- **631** raste ankesat kanë qenë objekt i punës së Shërbimit
- **207** raste ankesat kanë qenë jashtë objektit të punës së Shërbimit.

Nga hetimi administrativ në total i ankesave të ardhura në përfundim të verifikimit:

- Për **14** punonjës policie është bërë referimi në Prokurori.
- Për **41** punonjës policie është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore.

Krahasuar me vitin 2013, rezultatet e përfundimit të shqyrtimit të ankesave sipas grafikut të mëposhtëm:

- **3** punonjës policie referuar në 2013,
- **14** punonjës policie referuar në 2014,
- **15** punonjës policie sugjeruar për ecuri disiplinore në 2013,
- **41** punonjës policie sugjeruar për ecuri disiplinore në 2014



LINJA E GJELBËR 0800 90 90

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përjetësimit të Prioriteteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është zhvilluar fushat promovuese për linjën e gjelbër **0800 90 90** dhe vetë veprimtarinë e Shërbimit, me vendosjen e banderolave, kontaktimin e **233** shtetasve dhe shpërndarjen e kartvizitave, me qëllim njohjen e qytetarëve me misionin e shërbimit lidhur me ankesat e mundshme të tyre, për shkelje të ligjit, sjelljet joetike dhe veprime korruptive të punonjësve të policisë.

FUSHATA PROMOVUESE




Foto nga promovimi në 11 njësitë bashkiake në Tiranë dhe vendosja e banderolave në komisaritet e DPQ Tiranë



Foto nga fushata promovuese për linjën jeshile 0800 90 90 dhe vetë Shërbimin në rrugët kryesore nacionale të vendit

Pasqyrimi më i mirë i rezultateve të kësaj fushte promovuese janë të dhënat statistikore mbi linjën leshile për vitin analizues dhe falenderimet e shumë qytetarëve të cilët janë shprehur të kënaqur nga puna e kryer nga strukturat e Shërbimit për zgjidhjen e ankesave të tyre, konkretisht:

2901 thirrje telefonike për vitin 2014, kundrejt **508** thirrje telefonike për vitin 2013, pra **5.7** herë më shumë telefonata.



FALENDERIME TË QYTETARËVE:

Shtetasja Hasime Muça, denoncim për një ndërtim pa leje. Në koordinim me DPQ Tiranë dhe INUK është bërë shembja e këtij ndërtimi pa leje. Në përfundim të procesit qytetarja ka falenderuar Shërbimin për ndihmën e ofruar dhe zgjidhjen e këtij rasti.

Shtetasja Armina Kapxhiu, denoncim në linjën e gjelbër mosveprimet e punonjësve të Policisë lidhur me kontrollin e lokaleve të natës të cilët vazhdonin të shkaktonin zhurmë pas orës 23:00. Në përfundim të verifikimeve dhe zgjidhjes së këtij problemi shtetasja na ka falenderuar dhe ka shënuar se të gjitha institucionet e tjera duhet të marrin shembull për mënyrën se si trajtohet çështja dhe pritjet qytetari.

Shtetasi Hilmi Çela, ankesë për shkelje të procedurave të shoqërimit të tij nga ana e punonjësve të K.P. Kavajë. Pas hetimit administrativ ka rezultuar se ankesa e shtetasisit qëndronte. Rasti i është referuar Drejtorisë së Standardeve Profesionale në D.P.P. për fillimin e ecurisë disiplinore për 2 punonjës policie. Shtetasi me anë të telefonit, ka falenderuar për korrektësinë dhe përgjegjshmërinë e treguar.

Shtetasi Erald Agai, denoncim për shkeljen e procedurave për pranim në Komisariatin e Forcave Speciale RENE. Nga verifikimet rezultoi se ankesa e tij qëndron dhe i është dërguar informacion D.P.P. si organi kompetent për ndjekjen dhe trajtimin e këtij rasti. Shtetasi ka falenderuar për verifikimet e kryera nga ana jonë.

Shtetasja Linda Spahiu është ankuar për një çështje jashtë objektit të shqyrtimit të Shërbimit dhe i është dhënë ndihma ligjore lidhur me rrugën që duhet të ndjekë për zgjidhjen e problemit të saj. Me anë të një sms-je shtetasja na ka falenderuar për ndihmën dhe mbështetjen e dhënë.

Ish-punonjësi i policisë Astrit Kojo, është ankuar për përjashtim në mënyrë të padrejtë nga strukturat e Policisë së Shtetit, duke pretenduar standard të dyfishtë për trajtimin e rastit për të njejtën shkelje. Pas kryerjes së hetimit administrativ rezultoi se pretendimet qëndronin dhe materiali i është referuar për njohje dhe zbatim strukturave të Policisë së Shtetit dhe i është kthyer përgjigje qytetarit.

SEKTORI I INSPEKTIMIT TË PËRGJITHSHËM

Ky sektor ka kryer gjatë vitit 2014, gjithsej **66** inspektime, e konkretisht:

- **10** inspektime kundrejt 12 inspektime të planifikuara në Planin Vjetor.
- **15** inspektime të pa-planifikuara,
- **2** inspektime në bashkëpunim me Inspektimin e Përgjithshëm të MPB,
- **4** inspektime në bashkëpunim me Departamentin e Hetimit të Shërbimit,
- **3** inspektime studimore,
- **24** inspektime për trajtimin e ankesave të qytetarëve.


Janë dhënë **162** rekomandime strukturave të inspektuara për përmirësimin e punës dhe korrigjimin e parregullsive.

Nga këto Inspektime, rezultatet konkrete janë:

- Për **112** punonjës policie është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore.
- Në **6** raste materialet janë referuar në prokurori, në ngarkim të **9** punonjësve të policisë.
- Është rekomanduar rivlerësimi i procedurave të pranimit/ripranimit në punë për **76** punonjës.
- Për **6** punonjës policie është rekomanduar trajnimi përkatës.
- Për **9** punonjës policie është bërë këshillimi si masë jo disiplinore.
- Janë ngarkuar për zhdëmtim, **20** punonjës policie, pasi kanë shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 4 683 000 lekë (keqpërdorimi i karburantit).

Krahasuar me vitin 2013, gjatë vitit 2014 ka patur rritje sasiore dhe cilësore të veprimtarisë inspektuese:

- **37** inspektime në vitin 2013, në **66** inspektime në vitin 2014, ose **1.7** herë më shumë.
- **9** inspektime të paplanifikuara në 2013, në **15** inspektime të paplanifikuara në 2014, ose **1.6** herë më shumë.
- **2** referime në prokurori në vitin 2013, në **6** referime në 2014, ose **3** herë më shumë.
- **12** raste të trajtimit të ankesave në 2013, në **24** raste në 2014, ose **2** herë më shumë.



STRUKTURAT E KËRKIM-HETIMIT DHE DREJTIMIT TË HETIMIT

Veprimtaria hetimore ka patur si prioritet thelbësor forcimin e hetimit në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit nga punonjës të Policisë së Shtetit.

Strukturat e kërkim-hetimit dhe drejtimit të hetimit në nivel qendror e vendor të Shërbimit janë përpjekur në ngritjen e çështjeve hetimore të sukseshme bazuar tek procesi informativ, ngritjes së proceseve proaktive dhe përdorimit të mjeteve, teknikave dhe metodave speciale të hetimit. Të dhënat statistikore flasin për rritje të konsiderueshme sasiore dhe cilësore në këto procese, e konkretisht:

Proçeset informative:

- **84** procese informative për 2014, kundrejt **39** proceseve informative për 2013, pra **2.1** herë më shumë.

Përdorimi i teknikave dhe metodave speciale të hetimit:

- **130** raste të përdorimit të teknikave dhe metodave speciale të hetimit për vitin 2014, kundrejt **76** rasteve të përdorura për vitin 2013, pra **1.7** herë më shumë.

Nga përdorimi dhe aplikimi i metodave dhe teknikave të veprimtarisë informative dhe asaj proaktive të hetimit, janë dërguar pranë organit të Prokurorisë materialet kallëzuese ndaj punonjësve të policisë që dyshohet se kanë kryer elementë të veprës penale, e konkretisht:

- Janë referuar **227** kallëzime penale,
- Janë proceduar **279** punonjës policie, nga të cilët:
 - **3** punonjës policie të nivelit të lartë drejtues,
 - **3** punonjës policie të nivelit të mesëm drejtues,
 - **89** punonjës policie të nivelit të parë drejtues,
 - **167** punonjës policie të nivelit zbatues,
 - **17** punonjës policie civile dhe **18** shtetas.

57 persona të ndaluar/arrestuar në flagrancë, nga të cilët **48** punonjës policie dhe **9** shtetas.

Sipas nivelit punonjësit e policisë të arrestuar i ndajmë në **11** punonjës policie të nivelit të parë drejtues, **36** punonjës policie të nivelit zbatues dhe **1** punonjës policie civil.

Nga **227** kallëzime penale për vitin 2014, në:

- **85** raste për kallëzimet penale është vendosur mosfillim, pushim apo pezullim të çështjes.
- **100** raste kallëzimet penale janë në hetim.
- **42** raste për kallëzimet penale janë përfunduar hetimet dhe:
 - Në **23** raste çështjet penale janë sugjeruar për gjykim
 - Në **10** raste çështjet penale janë në gjykim
 - Në **9** raste përfunduar gjykimi në shkallën e parë, shpalljen fajtor dhe dënimin e **8** punonjësve të policisë dhe **1** shtetasi.

STATISTIKA KRAHASIMORE 2014 - 2013


Veprat penale në total

- 227 kallëzime penale për vitin 2014, kundrejt 134 kallëzime penale për vitin 2013, pra 1.7 herë më shumë.
- 279 punonjës policie të kallëzuar për vitin 2014, kundrejt 170 punonjës policie për vitin 2013, pra 1.6 herë më shumë.
- 57 persona të arrestuar/ndaluar për vitin 2014, kundrejt 27 personave të arrestuar/ndaluar për vitin 2013, pra 2 herë më shumë.

Rastet korruptive

- 161 kallëzime penale për raste korruptive, kundrejt 87 kallëzimeve penale për vitin 2013, pra 1.8 herë më shumë.
- 210 punonjës policie të kallëzuar për raste korruptive, kundrejt 117 punonjës policie të kallëzuar për vitin 2013, pra 1.7 herë më shumë.

Grafiku i mëposhtëm evidenton rritje të shkallës së zbulueshmërisë së rasteve korruptive të kryera nga punonjësit e policisë.



Hetime penale të sukseshme për vitin 2014

*Goditja e një grupi kriminal që merrej me trafik ndërkombëtar të armëve dhe municioneve, me shtrirje të aktivitetit kriminal brenda vendit dhe jashtë tij si në Kosovë. Në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda, hetimi proaktive u finalizuar me arrestimin në flagrancë të **Fadil Sula dhe Hamdi Matja**, me detyrë punonjës policie dhe 4 shtetasve bashkëpunorë të tyre. Gjatë zhvillimit të operacionit në cilësinë e provës materiale u sekuestruan: **12 780 fisheke automatiku e pistoletë, 4 armë automatike, një sasi e konsiderueshme pjesë armësh të cmontuara. Nga hetimet ka rezultuar se magazinieri i repartit ka furnizuar në mënyrë të vazhdueshme grupin me një sasi prej 1 milion fishekësh.***

Arrestohet në flagrancë punonjësi i policisë që grumbullonte armë e municione për t'i trafikuar. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e punonjësit të policisë **Ramazan Guri**, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës *materiale 1 automatik, 7 pushkë, 2 armë gjahu, 2 pako lëndë plasëse të llojit tritol, 8 granata dhe rreth 3500 fishekë të kalibrave të ndryshëm.* Aktualisht ndaj punonjësit të policisë është marra masa disiplinore e “Përrjashtimit nga Policia e Shtetit” dhe çështja është në gjykim.

Arrestohet në flagrancë Inspektor Lorenc Alia, për bashkëpunim me një trafikant të lëndëve narkotike nga Lazarati. Punonjësi i policisë ka shpërdoruar detyrën, duke abuzuar për qëllime përfitim gjatë procesit të shoqërimit dhe sekuestrimit të automjeteve të dyshuara në Lazarat. Për punonjësin e policisë është dhënë masa disiplinore e “Përrjashtimit nga Policia”, dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë me “8 muaj burg”.

Shtetësja denoncon shefin e Stacionit Policor për “favore seksuale, duke shpërdoruar detyrën”. Arrestohet **K/Inspektor Ernest Paluku**, shefi i Stacionit Policor Velipojë, për veprat penale “Shpërdorim detyre” dhe “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”. Aktualisht vazhdojnë hetimet dhe ndaj punonjësit të policisë është marrë masa disiplinore e “Përrjashtimit nga Policia e Shtetit”.

Arrestohet punonjësi i policisë për favorizim të zhvillimit të kundraligjshëm të lojrave të fatit. Shefi i stacionit policor të Divjakës, **N/Komisar Gjergji Çelaj**, dekonspironte operacionet e policisë kundrejt përfitimeve korruptive (monetare) ndaj disa bizneseve që zhvillonin në mënyrë të paligjshme lojrat e fatit. Aktualisht çështja në gjykim, punonjësit të policisë i është dhënë masa disiplinore “Përrjashtim nga Policia e Shtetit”.

Arrestohet në flagrancë punonjësi i policisë për shpërdorim detyre dhe organizim të paligjshëm të lojrave të fatit, Klevis Sorra, efektiv i Komisarariatit Special nr. 712. Aktualisht punonjësit të policisë i është dhënë masa disiplinore e “Përrjashtimit nga Policia e Shtetit” dhe çështja në gjykim.

Zbulohet dhe goditet veprimtaria korruptive dhe abuzimit me detyrën nga punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre funksionale, duke kërkuar dhe marrë përfitime monetare kundrejt favorizimit të veprimeve të kundraligjshme të kryera:

- **N/Komisar Albert Elezi**, specialisti i krimit financiar në Policinë e Shkodrës; i dënuar (me kusht për 4 vjet)
- **K/inspektorët Bledar Naçi, Benard Fejza dhe Gramoz Fasko**, ndihmës specialist të sektorit të narkotikëve dhe trafikeve të Policisë së Fierit;
- **Dritan Zagani**, Shefi i Seksionit të Luftës Kundër Narkotikëve në Policinë e Fierit;
- **Inspektor Alfred Hyso**, komandati i grupit të ndërhyrjes së shpejtë në Policinë e Sarandës;
- **Inspektorët Rexhep Lushka dhe Trifon Oçka**, efektiv të Pikës së Kalimit Kufitar Kapshticë së bashku me 1 shtetas; i dënuar (me 6 muaj burg).
- **Komisar Fatos Ahmati**, shef i stacionit të Policisë Kufitare, Shishtavec, Kukës, **N/Komisar Petrit Dauti**, përgjegjës turni në PKK Morinë dhe **Inspektor Behar Dida**, kontrollor në PKK Morinë, në bashkëpunim me 1 shtetas.

Pavarësisht, këtyre rezultateve konkrete të arritura gjatë vitit 2014, nga strukturat e Shërbimit në nivel qëndror e vendor, në përmbushje të objektit të veprimtarisë dhe misionit të Shërbimit, rezultate disa herë më të larta krahasuar me vitet e kaluara, mbetet ende shumë për të bërë në të gjitha drejtimet e veprimtarisë së Shërbimit.

PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2015

Implementimi i ligjit nr.70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”,
nëpërmjet:

– Implementimi i ligjit në aspektin ligjor të Shërbimit:

- Përfundimi i miratimit të paketës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.70/2014.
- Organizimi i veprimtarisë së shërbimit në përmbushje të zgjerimit të objektit të veprimtarisë si; trajtimi dhe inspektimi i ankesave; kryerja e testit të integritetit; kontrolli i pasurisë së pajustificuar të punonjësve të strukturave dhe analiza, studime e rekomandime për Strukturat mbi bazën e raporteve të hetimit dhe protokolleve të inspektimit.
- Organizimi dhe zhvillimi i veprimtarisë informative mbi bazën e rregullave dhe normave të miratuara dhe kontrolluara nga Prokurori i Përgjithshëm.
- Organizimi dhe zhvillimi i fazës paraprake të vërtetimit të të dhënave për punonjës të Strukturave që dyshohet se implikohen në veprimtari të kundërligjshme, për t'i paraprirë një stadi më të lartë të procesit informativ.
- Organizimi dhe kryerja e testit të integritetit, në të dy format, testi i përgjithshëm dhe testi i posacëm, mbi bazën e procedurave dhe rregullave të miratuara dhe kontrolluara nga Prokurori i Përgjithshëm.
- Organizimi dhe realizimi i hetimeve mbi kontrollin e pasurisë së pajustificuar të punonjësve të Strukturave, nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat e parandalimit të pastrimit të parave në Ministrinë e Financave.
- Organizimi dhe realizimi i procesit të paralajmërimit për punonjësit e Strukturave por edhe i rivendosjes së dinjetit, mbi bazën e rregullave dhe procedurave të normuara nga urdhra dhe udhëzime të Ministrit të Punëve të Brendshme.
- Vendosja e bazave të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese dhe shërbimeve të inteligjencës brenda kontureve të mirë përcaktuara ligjore si memorandume bashkëpunimi dhe protokolle veprimi dhe ndërveprimi të përbashkët, e konkretisht me Strukturat e Anti-Korrupsionit dhe Hetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe me Inspektoriatin Policor të Kosovës.

– Implementimi i ligjit në aspektin organizativ-strukturor:

- Organizimi strukturor i Shërbimit, në funksion të rregullimit të raporteve të parashikuara në ligj ndërmjet personelit me grada dhe atij pa grada të Shërbimit.
- Organizimi strukturor i Shërbimit sipas strukturës dhe përbërjes organike të miratuar me urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme.
- Implementimi i strukturave të reja dhe vënia në efikasitet të tyre, në funksion të zgjerimit të fushës së zbatimit të ligjit, duke ushtruar kontroll ndaj Strukturave.

- Implementimi i strukturave të reja dhe vënia e tyre në efikasitet, në funksion të zgjerimit të objektit të veprimtarisë së Shërbimit, kryesisht atë të trajtimit dhe inspektimit të ankesave e marrëdhënieve me publikun si dhe atë të analizave, studimeve dhe rekomandimeve për Strukturat, mbi bazën e raporteve të inspektimit dhe protokolleve të hetimit, mbi pritshmëritë e publikut për rendin dhe sigurinë publike.
- Modernizimi i strukturave të Shërbimit nga pikëpamja infrastrukturore dhe për rritje të efikasitetit dhe efikasitetit nga pikëpamja funksionale.
- Ndërtimi i bazës së dhënave për informacionin dhe dokumentat e prodhuara gjatë veprimtarisë informativo-gjurmuese dhe hetimit penal, me qëllim administrimin, përpunimin, menaxhimin, analizimin dhe shfrytëzimin e tij, në kohë reale, me efikasitet dhe efikasitet.
- Ndërtimin dhe vënien në efikasitet të bazës së të dhënave të personelit të Shërbimit, për të patur një pasqyrim të plotë të të gjithë ecurisë në karrierë, masat disiplinore, promovimet apo shpërblimet e deri tek largimet apo përjashtimet nga strukturat e Shërbimit.

Trajtim i ankesave të publikut, inspektimet dhe rekomandimet për Strukturat.

- Organizimi dhe ndjekja në kohë, me cilësi dhe efikasitet e çdo rasti/informacioni apo ankesë të publikut, ndaj punonjësve të Strukturave.
- Vënia në efikasitet të plotë e bazës së të dhënave për administrimin, menaxhimin dhe analizimin e ankesave/informacioneve/rasteve të evidentuara nga publiku dhe jo vetëm, nga struktura e inspektimit të ankesave të Shërbimit.
- Inspektimet tematike dhe njohëse të strukturave për monitorimin e zbatimit të objektivave dhe prioritetëve të përcaktuara nga Strukturat, subjekte të inspektimit gjatë vitit në vazhdim.
- Analiza, studime dhe rekomandime në bashkëpunim me strukturën e analizës së shërbimit, mbi format dhe tendencat e shkeljeve të evidentuara nga ankesat e publikut si dhe pritshmëritë e publikut në lidhje me performancën e strukturave, në veçanti të atyre në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun si policia rrugore, policia e rendit, policia kufitare, krimi ekonomik-financiar, policisë së ruajtjes nga zjarri dhe për shpëtimin etj.

Forcimi dhe rritja e cilësisë së hetimit administrativ dhe penal në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit në radhët e punonjësve të Strukturave.

- Fokusimi i veprimtarisë informativo-gjurmuese e asaj hetimore në ngritjen e proceseve proaktive të hetimit në goditjen e veprimtarisë korruptive apo implikimit në krim të organizuar të punonjësve të Strukturave.
- Rritje të kapaciteteve hetimore në zbulimin dhe goditjen e rasteve të korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit nga punonjës të Strukturave, duke rritur përdorimin e aplikimit të teknikave të posaçme të hetimit, nën drejtimin dhe kontrollin e Prokurorisë.
- Organizimi dhe aplikimi i procedurave të miratuara gjatë zhvillimit të testit të integritetit, të përgjithshëm dhe atij të posaçëm, për verifikimin e etikës dhe integritetit të punonjësit të

strukturave, me qëllim parandalimin e korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit në radhët e punonjësve të Strukturave.

- Rritje të bashkëpunimit dhe efikasitetit të tij me agjencitë e tjera ligjzbatuese në vend, në përmbushje të objektit të veprimtarisë së Shërbimit, konkretisht:
 - Bashkëpunimi me prokurorinë, i cili mbetet primar, duke qenë se vetë Shërbimi ka kaluar tashmë në një stad të ri, ku i gjithë personeli i Shërbimit (operacional e inspektues) gëzojnë dhe ushtrojnë atributet e oficerit të policisë gjyqësore.
 - Me strukturat e parandalimit të pastrimit të parave në Ministrinë e Financave, për realizimin e hetimeve në lidhje me pasuritë e pajustificueshme të punonjësve të Strukturave, mbi bazë ankesash dhe kallëzimesh.
 - Me Strukturat e Anti-Korrupsionit dhe Hetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për hetimin e rasteve të korrupsionit dhe kryerjes së testit të integritetit për punonjësit e policisë në PPKK dhe atyre të doganave.
 - Bashkëpunimi me Strukturat, në veçanti me strukturat e Policisë së Shtetit, në funksion të përmbushjes së objektit të veprimtarisë së Strukturave dhe të Shërbimit, i cili arrihet nëpërmjet:
 - shkëmbimit të informacionit,
 - operacioneve të përbashkëta për hetimin e veprave penale,
 - organizimi dhe ndjekja e planeve të përbashkëta veprimi për ngjarje apo problematika të ndryshme,
 - organizimi dhe zhvillimi i testeve të përgjithshme apo të posacme të integritetit,
 - trajnime e workshope të përbashkëta, të personelit të Strukturave e Shërbimit etj.

Trajnim i vazhdueshëm, promovim të ecuresë në karrierë dhe motivim të personelit.

- Hartimi i Manualit për Trajnimin e Brendshëm të Personelit të Shërbimit.
- Trajnimi i personelit me status të nëpuësit civil, në muajt Janar e Shkurt 2015, të organizuar nga ASPA.
- Trajnimi i personelit me grada dhe pa grada, mbi bazën e programit të “trajnimin të brendshëm”, të miratuar nga Ministri.
- Workshop i organizuar me ndihmën e TAIEX, në periudhën Prill – Maj 2015, me temë “hetimi i korrupsionit në polici”.
- Trajnime të organizuara dhe financuara nga partnerët tanë ICITAP dhe PAMECA-IV.

SI MUND TË NA KONTAKTONI

Adresa: Sheshi “Skënderbe”, Nr.3, Tiranë.

Tel/Fax: +355 4 22 71 735 & +355 4 22 53 516

Linjë telefonike pa pagesë per ankesat **0800 90 90**

Web-site: www.shcba.gov.al, ku mund të merrni informacionin mbi veprimtarinë e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat si dhe mbi të gjitha portat e mundshme të komunikimit me Shërbimin.

E-mail: shcba@punetebrendshme.gov.al, ku mund të dërgoni ankesa, informacione, etj, për shkelje të ligjit nga punonjës të Strukturave.

Spektori i Inspektimit të Ankesave/Zyra e Ankesave në godinën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku mund të depozitoni ankesën tuaj duke plotësuar formularin përkatës.

Drejtoria/Sektorët e Shërbimit në Qarqe

Mund të kontaktoni drejtpërdrejt punonjësit tanë të cilët gjenden pranë çdo strukture policore në nivel qarku, si në Drejtoritë dhe Komisaritet e Policisë.

Ankesat ndaj punonjësve të policisë mund t'i bëni edhe pranë çdo strukture të Policisë së Shtetit.

Kutitë postare të Shërbimit në Drejtoritë e Policisë në Qarqe dhe Komisariate.